



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/ Ministarstvo Obrazovanja, i Naukei / Ministry of
Education and Science*

Prishtinë, 22.04.2025

Në bazë të Rregullores MF- Nr – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, **Divizioni i Arsimit të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta** *nxjerr këtë:*

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti

1. **Divizioni i Arsimit të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta** , u bën thirrje të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në promovimin e këtyre nxënësve

2. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat prioritare në vijim:

- 1. Hartimi i programeve për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente.*
- 2. Ngritja e kapaciteteve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshëm , me dhunti dhe talente.*
- 3. Përkrahja e garave për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.*
3. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë në një projekt që kontribuon në përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente.

- ✓ Trajnimin e mësimdhënësve për identifikimin dhe përkrahjen e fëmijëve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Trajnimin e trajnerëve për ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Trajnimin e psikologëve për identifikimin dhe vlerësimin e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.
- ✓ Aktivitete që synojnë organizimin dhe mbështetjen e garave në fusha të ndryshme.

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 150,000.00 €.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10.000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 50,000.00 €.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga data e hapjes dhe përfundon me datën 15.05.2025

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me një projekt në kuadër të kësaj thirrje. Periudha e zbatimit të projektit është 8 deri në 12 muaj, duke filluar nga muaji shtator 2025.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku 3 vite para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga fushat prioritare të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikuesit, janë në dispozicion në faqen e internetit të *MASHT*.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rruga “Agim Ramadani”, nr. 10000, Prishtinë.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: elvira.matoshi@rks-gov.net